

VENDIM
Nr. 618, datë 31.8.2016

PËR FINANCIMIN E URDHRIIT PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 113/2015, “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar për një periudhë njëvjeçare, në masën 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
 3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama